



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 19 qershor 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit për
Dorëzimin e Përgjigjes ndaj Mocionit të Dytë të Prokurorisë për Konstatim
Gjyqësor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera(F02365)**

Prokurores së Specializuar
Kimberli P. Uest

Mbrojtja e Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Luka Mishetiç

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 21(4)(c) dhe 40(2) të Ligjit nr. 05/L 053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 9(5)(a) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 7 qershor 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi mocionin e dytë për konstatimin gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera ("Mocioni").¹
2. Më 14 qershor 2024, ekipet e Mbrojtjes së Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit (bashkërisht, "Mbrojtja") kërkuan bashkërisht zgjatjen e afatit për dorëzimin e përgjigjes ndaj Mocionit ("Kërkesa").²

II. PARASHTRIMET

3. Mbrojtja kërkon zgjatjen e afatit për dorëzimin e përgjigjes ndaj Mocionit deri të enjten, 11 korrik 2024.³ Mbrojtja parashtroi se zgjatja e afatit do t'i mundësojë të shqyrtojë siç duhet faktet e propozuara dhe t'i përgjigjet Mocionit, duke garantuar njëkohësisht që Trupi Gjykues më pas do të ketë kohë të mjaftueshme për të marrë vendim mbi Mocionin, pa shkaktuar vonesa në orarin aktual të seancave gjyqësore.⁴

¹ F02365, Prokurorja e Specializuar, Mocioni i Dytë i Prokurorisë për Konstatimin Gjyqësor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera, 7 qershor 2024, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 10 qershor 2024).

² Korrespondenca 527.

³ Korrespondenca 527.

⁴ Korrespondenca 527.

4. Sipas Mbrojtjes, ZPS-ja i ka komunikuar *inter partes* se nuk kundërshton “zgjatjen e arsyeshme të afatit”.⁵

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Në bazë të rregullës 9(5)(a), nëse i tregohen arsye të vlefshme, ose *proprio motu*, paneli mund të zgjasë afatet e përcaktuara prej Rregullores apo prej panelit.

IV. DISKUTIM

6. Paraprakisht, Trupi Gjykses vëren se kërkesa për zgjatjen e afatit (ose tejkalimin e numrit të lejuar të faqeve) normalisht duhet të bëhet me anë të një kërkesë zyrtare që i dorëzohet Zyrës Administrative, dhe jo me mesazh elektronik.⁶ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses urdhëroi Zyrën Administrative që mesazhin elektronik të dërguar nga Mbrojtja, në të cilin Mbrojtja kërkonte zgjatjen e afatit, ta protokollonte si korrespondencë.

7. Trupi Gjykses konstaton se Kërkesa është bërë në kohë, pasi është parashtruar në kohë të mjaftueshme para përfundimit të afatit përkatës.

8. Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja ka treguar arsye të vlefshme për zgjatje të kufizuar të afatit, veçanërisht duke marrë parasysh numrin e konsiderueshëm të fakteve për të cilat ZPS-ja i kërkon Trupit Gjykses konstatimin gjyqësor (172), si edhe parashtrimet e tjera dhe përgatitjet për seancat gjyqësore, që do të ndikojnë në burimet e Mbrojtjes në javët e ardhshme.

9. Megjithatë, Trupi Gjykses është i mendimit se në rrethanat konkrete, zgjatja e afatit e kërkuar nga Mbrojtja është e paarsyeshme dhe joproporcionale. Trupi Gjykses vlerëson se, për të siguruar efikasitetin dhe shpejtësinë e procesit si dhe

⁵ Korrespondenca 527.

⁶ *Shih* Korrespondencën 527.

që të akuzuarit të kenë kohë të mjaftueshme për t'iu përgjigjur Mocionit, një afat më i shkurtër se ai i kërkuar, deri të hënën, 1 korrik 2024, është i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm në këto rrethana.

10. Bazuar në sa më sipër, Trupi Gjykses zgjatë afatin e Mbrojtjes për dorëzimin e përgjigjes ndaj Mocionit deri **të hënën, 1 korrik 2024**.

V. VENDIM

11. 17. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **MIRATON** Kërkesën, pjesërisht; dhe
- b) **ZGJAT** afatin e Mbrojtjes për dorëzimin e përgjigjes ndaj Mocionit deri **të hënën, 1 korrik 2024**.

/nënshkrimi/

Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E mërkurë, 19 qershor 2024

Në Hagë, Holandë.